REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin aktiv të Entit Rregullator të Energjisë, si autoriteti i vetëm dhe i pavarur rregullator në vend për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;
- Duke vlerësuar arritjen tashmë disavjeçare të Qeverisë për furnizimin pa ndërprerje të konsumatorëve me energji elektrike;
- Duke njohur rëndësinë e shfrytëzimit optimal të rezervës hidroenergjetike, si dhe faktin që viti 2011 ishte një vit me prurje ujore të ulëta;
- Duke njohur rëndësinë e përmirësimit të efiçencës së energjisë, si dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik;
- Duke konsideruar rëndësinë që ka liberalizimi i tregut të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike;
- Duke pasur parasysh faktin që ky vit ishte i rëndësishëm, në kuadër të angazhimeve të vendit në kuadër të traktatit të Komunitetit të Energjisë për vendet e Europës Juglindore, lidhur me liberalizimin e kapaciteteve të energjisë elektrike;
- Duke vlerësuar si shumë të rëndësishme punën për realizimin e mundësisë së furnizimit të vendit me gaz natyror, nëpërmjet alternativave më të favorshme dhe për përgatitjen e kuadrit rregullator në këtë fushë;
- Duke pasur parasysh rritjen e konsiderueshme të konsumatorëve që i drejtohen ERE-s për zgjidhjen e ankesave të tyre;

Konstaton se ERE në vitin 2011:

- Ka vazhduar plotësimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë, duke pasqyruar angazhimet e marra nga vendi ynë, në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike dhe të integrimit europian, si dhe duke u mbështetur në parimet e konsultimeve publike me grupet e interesit në proceset vendimmarrëse të saj, me qëllim që këto vendimmarrje të balancojnë interesat e shtetit, të konsumatorëve dhe të investitorëve në sektorin e energjisë.
- Ka miratuar, nëpërmjet procedurave transparente dhe gjithëpërfshirëse, kontratën e re të furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë dhe Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike, duke plotësuar detyrimin, në përputhje me Deklaratën Rregullatore për miratimin e kushteve të reja të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorit dhe duke garantuar kërkesat e konsumatorëve tariforë për mbrojtjen e interesave të tyre nga natyra monopol e këtij shërbimi.
- Ka ushtruar në mënyrë të vijueshme autoritetin e tij për monitorimin e të gjithë operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike, në lidhje me mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, efiçencës dhe cilësisë së shërbimit që ata ofrojnë për konsumatorët.
- Ka garantuar mbrojtjen e vazhdueshme të interesave dhe të drejtave të konsumatorëve tariforë, nëpërmjet trajtimit me përkushtim, transparencë, paanshmëri dhe brenda afateve ligjore të ankesave të konsumatorëve.
- Ka punuar në zhvillimin e kapaciteteve të veta institucionale për krijimin e kuadrit të domosdoshëm rregullator në fushën e gazit natyror, të harmonizuar me direktivat e BE-së dhe me vendet e rajonit, duke u fokusuar kryesisht në mbështetjen e gjithanshme të përpjekjeve për konkretizimin e projektit TAP, për të krijuar hapësirat e nevojshme për interesat shqiptarë në të.
- Nëpërmjet një procesi transparent e profesional dhe në përputhje me metodologjitë përkatëse, ka përcaktuar tarifat dhe çmimet për veprimtarinë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për klientët tariforë, sikurse çmimet e shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e vegjël.
- Me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit në vend dhe në kuadër të një klime promovuese për

investimet e reja, ka licencuar 39 subjekte juridike në prodhim energjie, tregtues energjie, furnizues të kualifikuar të energjisë elektrike, si dhe modifikime të licencave ekzistuese.

- Në mënyrë transparente është angazhuar në dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në tregun e energjisë elektrike.
- Në funksion të rritjes së transparencës dhe përmirësimit të shërbimeve të ofruara në sektorin e energjisë, është angazhuar në publikimin e informacionit për kushtet e kryerjes së shërbimeve nga kompanitë e licencuara në sektorin e energjisë.
- Ka konsoliduar akoma më shumë marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera shtetërore dhe ka vazhduar të ndjekë një formë bashkëpunimi dhe informimi periodik për zgjidhjen e sfidave të ndeshura në procesin e rregullimit të sektorit të energjisë elektrike.

Kërkon që ERE për vitin 2012:

- Të vazhdojë monitorimin e tregut të energjisë elektrike, për të rritur transparencën dhe garantuar mosdiskriminimin, nëpërmjet procesit të hartimit të rregullave dhe rregulloreve, për të nxitur konkurrencën në këtë treg dhe orientimin e tij drejt liberalizimit të mëtejshëm.
- Të punojë për hartimin e rregulloreve për lidhjet e reja në të gjitha hallkat e sistemit të energjisë elektrike, me synimin për shkurtimin e afateve dhe zbatimin e procedurave transparente për realizimin e furnizimit me energji të bizneseve dhe konsumatorëve familjarë.
- Të rishikojë kodet e transmetimit, të shpërndarjes dhe të matjes së energjisë elektrike, në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Paketën e Tretë Rregullatore të Bashkimit Europian.
- Të intensifikojë më tej punën për monitorimin e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, në mënyrë të veçantë të kompanisë CEZ Shpërndarje, për realizimin e treguesve kryesorë të saj në arritjen e objektivave për reduktimin e humbjeve në rrjet dhe rritjen e arkëtimeve.
- Të angazhohet me përparësi në plotësimin e kuadrit rregullator dhe kryerjen e procedurave të nevojshme për mbështetjen e projekteve me interes kombëtar për gazifikimin e vendit.
- Të vazhdojë të garantojë mbrojtjen e konsumatorëve të energjisë elektrike, nëpërmjet trajtimit me përkushtim të ankesave të konsumatorëve dhe hartimit të standardeve të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve nga ana e të licencuarve.
- Të monitorojë cilësinë e shërbimit të ofruar konsumatorëve për të garantuar furnizim të pandërprerë me energji elektrike në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me standardet minimale të cilësisë së shërbimit të energjisë, të miratuara nga ERE.
- Të hartojë rregulloren e procedurave të vendosjes së gjobave për të licencuarit, në rastet e kundërvajtjeve administrative të kryera prej tyre, ku të përcaktohen aspektet e posaçme të kushteve dhe procedurave që duhet të ndiqen nga ana e ERE-s, si dhe shkeljet e detajuara, të cilat përbëjnë shkak për ndëshkimin e tyre.
- Të rishikojë modelin e tregut të energjisë elektrike, duke pasur në konsideratë ndryshimet e fundit në legjislacion dhe kushtet e reja të hapjes së tregut dhe përshtatjes së tij me tregun rajonal.
- Të hartojë rregullat dhe procedurat për trajtimin e shërbimeve ndihmëse në sektorin elektroenergjetik.

17 maj 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)